



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1935, datë 07.05.2012

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1763, datë 2.2.2012 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 07.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1763, datë 2.2.2012 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”.

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkruesore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Fax : + 355 4 2259 106

www.akep.al

info@akep.al

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1763, datë 2.2.2012 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.
 - Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 869Prot, datë 17.2.2012, (nr. 337Prot. i AKEP, datë 17.2.2012) “Mbi depozitimin e pretendimeve në zbatim të vendimit nr. 1763, datë 2.2.2012, lidhur me procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Neofone sh.p.k.”;
 - Shkresa e Neofone sh.p.k., me nr. 131Prot., datë 16.2.2012 (nr. 347Prot. i AKEP, datë 20.2.2012) “Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1763, datë 2.2.2012”;
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1763, datë 2.2.2012, të Këshillit Drejtues “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
 - I. *Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.;*
 - II. *Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;*

III. *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;*

II. Albtelecom sh.a., me shkresën nr. nr. 869Prot, datë 17.2.2012, ka sjellë pretendimet në lidhje me procedimin administrativ dhe sqaron qëndrimin e tij si më poshtë:

1. Albtelecom sh.a. thekson se kërkesa e Neofone sh.p.k. për të nënshkruar një marrëveshje interkoneksioni me terma e kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në RIO-n e Albtelecom publikuar që në prill, 2011 dhe në marrëveshjet e lidhura me 70 operatorë të tjerë, është një kërkesë e pambështetur, e paarsyeshme dhe aspak në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator;
2. Albtelecom sh.a. sqaron se Neofone sh.p.k. u ftua bashkë me gjithë operatorët e tjere në negociim, të arrinin dakortësinë dhe të nënshkruanin MI sipas RIO-s së publikuar. Neofone refuzoi nënshkrimin e MI, paverësisht se të gjithë operatorët e realizuan këtë proces, dhe për një hark kohor prej dy muajsh nuk ka paraqitur asnjë pretendim apo kundërshtim të atij dokumenti i cili do të përbënte bazën e marrëveshjes së re interkoneksionit.
3. Albtelecom ka ofruar vazhdimisht sqarime për Neofone në lidhje me pretendimet e tyre të mëvonshme, madje dhe duke i ftuar për të rishikuar qëndrimin e tyre dhe nënshkrimin e MI sipas kushteve dhe termave të RIO-s së Albtelecom të publikuar.
4. Albtelecom, thekson se Neofon-it i ka ofruar të nënshkruajë MI me të njëjtat kushte dhe terma që iu është ofruar dhe gjithë operatorëve të tjerë, si dhe është njoftuar për mundësinë e amendimit në ëdo kohë që mund të ketë ndryshime në RIO-n e publikuar. Gjithashtu, theksojmë se nuk është Neofone që vlerëson ligjshmërinë e RIO-s së Albtelecom.
5. Megjithëse trajtimi i pretendime të Neofone lidhur me shërbimin e kartës së parapaguar nuk mund të jetë objekt i këtij procedimi administrativ që lidhet me shërbimet e interkoneksionit, Albtelecom sqaron gjithësesi, ashtu si çështja e trajtimit të segmenteve të origjinimit ashtu edhe përcaktimi i kohës së tarifueshme, janë çështje të ezauruara dhe të mirëpritura jo vetëm nga AKEP dhe kuadri rregullator por edhe standartet e praktikave ndërkombëtare.
6. Gjithashtu, Albtelecom sqaron se edhe për nënshkrimin e marrëveshjes së aksesit interkoneksionit për OSHKP, Neofone duhet t'i referohet RIO-s për aspektin procedural të lidhjes dhe gjithashtu për aspektin material të saj.
7. Megjithë frymën negative ndaj Albtelecom, e cila pëshkon të gjithë shkresat e Neofone, pa argumenta profesionale e që shtrembërojnë qëllimisht objektin e mosmarrëveshjes, Albtelecom ka shprehur gadishmërinë për të bashkëpunuar me Neofone nën termat e RIO-s dhe kuadrin rregullator në fuqi, në çdo rast që Neofone, e sheh të arsyeshme. Por deri atëherë Albtelecom nuk mund të mbajë të okupuara qarqet e interkoneksionit, facilitetet dhe resurset e përdorura për qëllime interkoneksioni me Neofone, në rrethanat kur Albtelecom ka më se 70 operatorë të interkonektuar në rrjetin e tij, dhe të tjerë që janë në proces interkonektimi.

8. Altelecom, kundërshton me forcë çdo akuzë të Neofone për vendosjen e praktikave të pandershme apo shkelje të kryera nga Altelecom. Njëkohësisht, Altelecom kërkon nga AKEP tërheqjen e vëmendjes së Neofone për adresimin në mënyrë korrekte, etike dhe profesionale të çështjeve dhe mosmarrëveshjeve me Altelecom.

III. Neofone sh.p.k. me shkresën nr. 131Prot., datë 16.2.2012, ka sjellë parashtrimet përfundimtare, ku sqaron se:

1. Tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri, është tërësisht i orientuar në tregun e komunikimeve elektronike në Europë, në përputhje me rekomandimet e direktivat e BE. Nuk ekziston anjë rast në Europë që operatori incumbent të detyrojë operatorët alternativë të firmosin me detyrim një marrëveshje interkoneksioni me tarifa të pasesgmentuara në mënyrë gjeografike sipas segmenteve Lokal, Rajonal dhe Kombëtar. Operatori Altelecom sh.a. është rast i vetëm në Europë.
2. Neofone, duke iu referuar shkresave të paraqitura (*në fillim të procedimit*), shprehet se të gjitha pretendimet e Altelecom, nuk bazohen në asnjë nen apo VKD të kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, apo ndonjë praktikë të vendeve të BE.
 - 2.1 Tarifa e vendosur nga Altelecom sh.a. për terminimin e thirrjeve e cila përkon me segmentit dyfish si për thirrjet lokale ashtu edhe për ato rajonale. RIO e Altelecom dhe MI që i ka paraqitur Neofone për të firmosur është në kundërshtim të hapur me ligjin nr. 9918, (neni 3/53, neni 31/3, neni 40, 41, 45, 48, 50,53, 55, 56, 57, 59, si dhe aktet juridike nëligjore (VKD) të AKEP të cilat janë në përputhje me hierarkinë e mësipërme ligjore. Bashkëngjitur, RIO e Telecom Italia e cila ndan si kudo në Europë, shërbimin e terminimit drejt rrjeteve fikse në tre segmente tarifimi: Lokal, Rajonal dhe Kombëtar, duke mos diskriminuar origjinën e trafikut.
3. Mënyra e tarifimit për platformat OSHKP-THK, e përcaktuar në RIO Ver. 1.0 dhe e implementuar në RIO Ver. 2.0, të Altelecom, përmban një metodologji tarifimi të pabazuar në asnjë standard të ITU, ETSI apo ndonjë praktikë të vendeve të BE. Kjo metodologji, sipas Neofone, rrjedhon si një marrëveshje ad-hoc tarifimi e shpikur dhe e implementuar enkas për Republikën e Shqipërisë, në mungesë të një praktike të BE, në kohën në të cilën është diskutuar dhe vendosur. Neofone, ka bashkëngjitur një Akt Juridik Nënligjor të AGCOM (Autorita per le Garanzie nelle Comunicazioni), që bazohet në qartë në standartet e ETSI dhe ITU, një praktikë e një vendi të zhvilluar të BE. Nisur nga kjo praktikë Neofone, kërkon implementimin e praktikës italiane (Delibera nr. 19/06/CIR).
4. Neofone sqaron se, praktika aktuale që Altelecom ka sugjeruar në RIO, është një metodologji absolutisht e pabazuar në asnjë praktikë momentale të BE, e as në standartet e ETSI e ITU, AGCOM, shkel parimet e konkurrencës së ndershme në treg pasi lë vend për barriera artificiale dhe dëmton konsumatorin pasi paguan një uzufukt të papërfutuar në rastin e thirrjeve të pasuksesshme drejt abonentit fundor.
5. Operatori FNT Altelecom ka ushtruar në mënyrë të paprecedent të gjithë fuqinë si operator me fuqi të ndjeshme në treg duke anuluar kapacitetet fizike të interkoneksionit. Kjo kundravajtje ligjore e Altelecom përkon me praktikën më ekstreme të përdorimit të

fuqisë së ndjeshme duke përbërë abuzimin më flagrant me pozitën dominuese. Nga qëndrimi i Albtelcom në seancën dëgjimore dukej qartë që nuk ishte i gatshëm të negocionte apo të ndryshonte asnjë nga elementët e RIO-s së pamiruar.

6. Kjo ndërprerje i ka shkaktuar Neofone një dëm financiar të pakonsiderueshëm.
7. Neofone sh.p.k., gjithashtu, ka referuar edhe “*Fourth observatory forum të Cullen International for monitoring electronic communications and information society services in the enlargement countries*” 4-5.11.2010, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina.

Sa më sipër, Neofone shpjegon se AKEP shprehet qartë se RIO e një operatori FNT hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga AKEP. Kështu konstatohet se RIO Ver. 2.0 dhe si rrjedhim dhe Marrëveshja e interkoneksionit e bazuar në të nuk ka fuqi ligjore deri në ditën e miratimit nga AKEP. Rrjedhimisht, Neofone sh.p.k. ka që prej muajit Qershor 2011 dhe në vazhdim për një periudhë gati 8-mujore që ka të mbyllura qarqet e interkoneksionit nga Albtelcom sh.a. si pasojë e një praktike të paprecedent me argumentin se Neofone ka refuzuar të nënshkruajë marrëveshjen e re të interkoneksionit.

8. Në përfundim, Neofone sh.p.k. kërkon që vendimi i AKEP të jetë totalisht i bazuar në ligjin nr. 9918, dhe në mungesë të elementeve specifikuës, të ndiqen gjerësisht praktikat më të mira të vendeve të BE. Bashkëngjitur, Neofone ka paraqitur praktikat dhe qëndrimet konkrete të organizmave ndërkombëtare të cilëve iu është referuar.

Neofone kërkon specifikimin e qartë të termave të mosmarrëveshjes midis Albtelcom dhe Neofone, duke mos lënë vend për keqinterpretime nga palët.

IV. AKEP pasi ka shqyrtuar pretendimet e paleve vëren dhe vlerëson se,

1. Objekti i kryesor i mosmarrëveshjes midis Neofone dhe Albtelcom për lidhjen e MI është menyra e tarifimit për origjinimin e thirrjeve drejt platformës OSHKP. Vlen të theksohet se kjo çështje (mënyra e tarifimit për thirrjet drejt numrave OSHKP) është ankimuar nga Neofone edhe për RIO-t e AMC dhe Vodafone, të cilat përmbajnë të njëjtin paragraf për këtë çështje, dhe AKEP me vendimet Nr.1614 dhe Nr.1615, datë 22.06.2011, ka hedhur poshtë/nuk ka pranuar ankimin e Neofone. Megjithatë me qëllim dhënien e sqarimeve të mëtejshme për këtë pikë, AKEP më poshtë ka dhënë disa argumenta që mbështesin mënyrën e tarifimit të këtyre thirrjeve dhe vendim-marrjet e AKEP për këtë çështje.
2. Procesi i kryerjes së thirrjeve me karta të parapaguara nga ana e pajtimtarit të Albtelcom (apo të ndonjë rrjeti tjetër) kryhet në dy faza: thirrje e pajtimtarit drejt numrit të aksesit të OSHKP dhe pas një komunikimi me platformën (formimi i numrit të kartës, PIN dhe dëgjimi i llogarisë së mbetur) pajtimtatri formon numrin destinacion (palën që do të thirret) dhe operatori OSHKP kryen thirrjen drejt numrit destinacion për të cilën tarifon pajtimtarin e Albtelcom (komunikimi i pajtimtarit me platformën OSHKP vazhdon edhe pas mbylljes së telefonatës me destinacionin final të thirrur pasi vijnë alterantiva për një thirrje tjetër, gjendje llogarie e mbetur etj). Shërbimi që ofron operatori i rrjetit të aksesit ku është lidhur pajtimtari, është përcjellja e thirrjes së pajtimtarit deri në platformën e OSHKP. Më pas për rrugëzimin e thirrjes deri në destinacionin final është OSHKP

përgjegjës dhe kontrolluesi i cilësisë së thirrjeve si zgjedhja e rrugëzimit me kosto më të ulët, thirrje të cilat kryhen zakonisht me platforma VoIp për kosto më të ulët se trafiku i përcjellë me 'circuit switched'. Albtelecom duke përcjellë thirrjen dëri në numrin j-geografik 0801xxx apo platformën OSHKP, kompensohet për origjinim të thirrjeve të suksesshme deri në platformë kur platforma përgjigjet), ndërsa për thirrje drejt 0801xx (platformës) të cilat nuk përgjigjen nga platforma quhen thirrje të dështuara dhe nuk ka pgesë për origjinim të thirrjeve. Pra operatori OSHKP tarifohet nga Albtelecom për origjinimin e thirrjeve drejt numrit të tij të aksesit 0801xxx dhe jo për origjinim thirrje drejt numrit destinacion final. Kjo mënyrë tarifimi është e drejtë dhe e orientuar në përdorimin e resurseve të operatorit të rrjetit të aksesit (Albtelcom në këtë rast). Rasti është më evident në rast se Albtelecom do të ishte tranzitues i thirrjeve drejt 0801xxx: thirrja drejt OSHKP kryhet nga një abonent i operatorit X i interkonektuar me Albtelecom. Albtecom në këtë rast tranziton thirrjen nga pika e interkoneksionit me operatorin X drejt pikës së interkoneksionit me OSHKP, dhe koha e tarifueshme është koha që kalon në komunikimin midis operatorit X dhe OSHKP. Sipas pretendimeve të Neofone, Albtelecom në këtë rast duhet të tarifojë për transit vetëm kohën që abonenti i operatorit X komunikon me palën e thirrur.

3. Për sa më sipër AKEP gjykon se nuk ka nevojë për një rishikim të mënyrës së faturimit për thirrjet drejt OSHKP edhe në kushte kur Neofone ka dhënë disa referenca nga rregullatori italian AGCOM, pasi këto referenca nuk janë të qarta dhe detyruese për AKEP si dhe nuk përbëjnë një standart unik të BE apo ETSI. Sic është theksuar më lart, operatori OSHKP tarifohet nga Albtelecom për origjinimin e thirrjeve të suksesshme drejt numrit të tij të aksesit 0801xxx, dhe kjo është në përputhje me standartet e thirrjeve të suksesshme drejt numrave gjeografike.
4. Në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin Albtelecom ato janë të miratuara me VKD nr.1348 datë 26.07.2010 dhe për sa i përket trajtimit të segmenteve të trafikut hyrës ndërkombëtare, sipas pikës 5, neni 5 i rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit, një operator ka të drejtë që lloje të caktuara të trafikut ti pranojë në pika specifike interkoneksioni. Vlen të theksohet se për tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, AKEP me VKD nr.1742 datë 20.12.2011, ka vendosur që kjo tarifë të jetë jashtë rregullimit, duke miratuar edhe shtesat dhe ndryshimet përkatëse të RIO së Albtelecom me VKD nr.1884, datë 19.04.2012.
5. Nga pretendimet vihet re se trajtimi që Albtelecom i ka bërë Neofone në lidhje me shërbimet e ofruara është i njëjtë si me operatorët e tjerë, dhe Neofone nuk ka paraqitur pretendime që është trajtuar në mënyrë të ndryshme nga operatorët e tjerë. Pra Albtelecom nuk ka bërë diskriminim të Neofone ndaj operatorëve të tjerë, konkurrues të mundshëm të Neofone.
6. Pretendimet e Neofone për interkonektimin me Albtelecom kanë lidhje me shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe thirrjeve me kartë të parapaguar të Neofone dhe jo për shërbimin publik telefonik fiks të ofruar pajtimtarëve të rrjetit publik fiks Neofone. Neofone ka deklaruar se nuk ka pajtimtarë telefonik fiks për 2010 dhe 2011,

duke ofruar vetëm tranzitim thirrjesh. Në këto kushte AKEP gjykon se nuk është e nevojshme dhënie Urdhëri për lidhje MI midis dy operatorëve.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me Vendimin nr. 1763, datë 2.2.2012 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.
2. Albtelecom sh.a të lidhë Marrveshje Interkoneksioni me Neofone sh.a, nëse kërkohet nga Neofone, sipas kushteve dhe termave të marrveshjeve të Albtelecom me operatorët e tjerë.
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE